**ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia:** Operatori ekonomik duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve, të paraqesin problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojnë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, duhet të shpjegohet metodologjia që propozojnë të adoptojë dhe të paraqesin kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës

#### **ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:**

Operatori ekonomik duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në

---

<sup>4</sup> Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit nënkritereve.

plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret.

**ii/c. Organizimi dhe Stafi:** Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit të tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

**(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar**

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b. Eksperienca në fushën përkatëse

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

**2. Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:**

**Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë**

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

**Vlerësimi përfundimtar**

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

**Pesha për Propozimin Teknik:**  $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

**pesha për Propozimin Ekonomik:**  $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

**Oferta më e mirë = X + Y**

**Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

**SHËNIM:** 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

**22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra,

ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

## **O - Oferta**

### **MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**



**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

##### **23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

##### **24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;

- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

#### **25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

#### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e

prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    - 2. Njoftimin e Kontratës;
    - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
    - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

---

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

|                                           |  |
|-------------------------------------------|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |
| <b>Datë</b> _____                         |  |

**Shtojca 2.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

| 1                                         | 2                                                        | 3             | 4               | 5                    |                                    |
|-------------------------------------------|----------------------------------------------------------|---------------|-----------------|----------------------|------------------------------------|
| Nr.                                       | Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike | Njesia / muaj | çmimi për njësi | Çmimi total (3 x 4X) | Afati                              |
| 1.                                        | “Mirëmbajtja e sistemit MAXIMO”                          | Sherbim / 36  |                 |                      | 36 muaj nga nenshkrimi i kontrates |
| 2.                                        |                                                          |               |                 |                      |                                    |
|                                           | <b>Çmimi total</b>                                       |               |                 |                      | _____                              |
| <b>Çmimi Neto pa TVSH</b>                 |                                                          |               |                 |                      |                                    |
| <b>TVSH (%)</b>                           |                                                          |               |                 |                      |                                    |
| <b>Çmimi total me TVSH:</b>               |                                                          |               |                 |                      |                                    |
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |                                                          |               |                 |                      |                                    |

---

|                   |  |
|-------------------|--|
| <b>Nënshkrimi</b> |  |
| <b>Vula</b>       |  |
| <b>Datë</b> _____ |  |



---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### Shtojca 4.

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|-------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------|
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

## Shtojca 5.

*(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)*

### **DEKLARATË**

#### **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt .....është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 6.

*[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]*

---

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

---

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

---

**Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet: “Mirembajtjen e sistemit MAXIMO per nje periudhe 3 vjeçare”.**

**Afatet e ekzekutimit:** 36 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

| NR | Pershkrimi                                                  | Njesia  | Sasia   | Fondi Limit           |
|----|-------------------------------------------------------------|---------|---------|-----------------------|
| 1  | “Mirembajtjen e sistemit MAXIMO per nje periudhe 3 vjeçare” | Shërbim | 36 muaj | <b>113,992,488.00</b> |

---

## Shtojca 8.

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

### SPECIFIKIMET TEKNIKE/TERMAT E REFERENCËS

#### 1. AUTORITETI KONTRAKTUES

Autoritet Kontraktues është OSHEE - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a..

#### 2. QËLLIMI I SHËRBIMIT

Qëllimi i shërbimit është sigurimi i një kontrate mirëmbajtje 3 vjeçare për sistemin e menaxhimit Operacional - Teknik të aseteve të rrjetit, që OSHEE ka në përdorim. Komponentët kryesore të sistemit janë:

- |    |                                                      |                 |
|----|------------------------------------------------------|-----------------|
| 1. | Maximo Asset Management,                             | Aplikacioni IBM |
| 2. | infrastrukturës mbështetëse të zgjidhjes IBM Maximo, | HW dhe SW të    |
| 3. | optimizimi në infrastrukturën ekzistuese të OSHEE.   | Integrimi dhe   |

#### 3. OBJEKTI I SHËRBIMIT

Objekti kryesor i këtij shërbimi është mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit Operacional - Teknik të aseteve të rrjetit, dhe e komponentëve të tij, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës.

Komponentët kryesore të sistemit janë:

1. Aplikacioni IBM Maximo Asset Management
2. HW dhe SW të infrastrukturës mbështetëse të zgjidhjes IBM Maximo.
3. Integrimi dhe optimizimi në infrastrukturën ekzistuese të OSHEE.

Ky sistem është i centralizuar dhe i instaluar në infrastrukturën teknologjike të OSHEE, i mundëson OSHEE, rezultatet si më poshtë:

1. Dixhitalizimi i strukturuar i të dhënave në pajisjet teknike në bazën e sistemit qendror
2. Krijimi i proceseve të mirëmbajtjes korrektuese
3. Krijimi i proceseve të mirëmbajtjes parandaluese
4. Menaxhimi i materialeve të përdorura në mirëmbajtje
5. Organizimi dhe planifikimi i burimeve
6. Raportimi sistematik dhe analiza e të dhënave

#### 4. AFATI I SHËRBIMIT

---

Afati i shërbimit do të jetë për një periudhë 3 vjeçare.

## **5. ÇFARË ËSHTË SISTEMI**

Sistemi i Menaxhimit të Aseteve IBM® Maximo® është sistem i menaxhimit të ciklit jetësor të aseteve dhe i menaxhimit të procesit të rrjedhës së punës.

OSHEE, përmes këtij sistemi mundëson përpunimin e të dhënave të pajisjeve teknike për të përmirësuar shërbimin ndaj klientit dhe për të optimizuar investimin në pajisje teknike të rrjetit të shpërndarjes në tensionet TL dhe TM/TU (Nënstacion-Fider-Kabinë dhe Linjat) dhe shërbimet e lidhura me mirëmbajtjen e tyre. Në sistem janë implementuar procedurat operacionale në sektor për menaxhimin e pajisjeve teknike si dhe janë automatizuar proceset e punës të lidhura me to.

Procedurat operacionale të implementuara përfshijnë proceset që ndiqen nga punonjësit për të kryer shërbimet e mirëmbajtjes, kontrolleve periodike, riparimit të defekteve, si dhe orkestrimin e mjeteve dhe burimeve njerëzore për përgatitjen dhe ekzekutimin e urdhrave të punës.

Proceset operacionale të mirëmbajtjes dhe shërbimeve mbi pajisjet shoqërohen me raportim të vijueshëm në kohe reale të situatës së punimeve, me informacion të përditësuar mbi stokun e pajisjeve teknike si dhe ekzekutimin korrekt të kontratave të shërbimit me pale të tjera kontraktore që OSHEE ka lidhur përgjatë viteve për të garantuar mbarëvajtjen e rrjetit të shpërndarjes. Një bazë e mirë informacioni për të mbështetur këto procese janë të dhënat mbi pajisjet teknike të tensionit të mesëm të digjitalizuar tashmë në sistemin SAP si dhe të dhënat elektronike të bazës materiale për riparim që gjithashtu merret nga moduli i Magazinës në sistemin SAP.

Sistemi i përpunimit të të dhënave për pajisjet teknike i mundëson OSHEE të shohë treguesit kryesorë të performancës (KPIs) për të monitoruar kushtet e pajisjeve dhe për të nxitur veprim të automatizuar bazuar në tejkalimin e vlerave normale të paracaktuara. Sistemi ofron mundësinë për të krijuar, caktuar, monitoruar, njoftuar dhe raportuar komponentët kryesorë të procesit, të tilla si urdhrat e punës, shërbimit dhe urdhrat e blerjes, duke përfshirë statusin dhe informacionin bashkëngjitur.

Ky sistem është i instaluar në datacenter të OSHEE dhe është i centralizuar për të gjitha njësitë e shpërndarjes rajonale.

### **5.1. Modulet dhe Proceset e Punës**

#### **1. Moduli i Menaxhimit të pajisjeve teknike**

Moduli i menaxhimit të pajisjeve teknike ofron funksionalitet për të ruajtur detaje informuese për të gjitha pajisjet teknike, pjesët e këmbimit, performancën e pajisjeve teknike dhe historinë

---

e punës. Ky modul siguron ndjekjen dhe menaxhimin e të dhënave të pajisjeve (duke përfshirë vendndodhjen, punën dhe historinë e kostos), të krijojë vendndodhjen dhe hierarkitë e pajisjeve dhe lidhjet midis tyre, si dhe të ndjekë gjendjen dhe vendndodhjen e pajisjeve për të planifikuar mirëmbajtjen pro-aktive.

Funksionet kryesore të modulit të menaxhimit të pajisjeve:

- Hedhje të dhënash për pajisjet teknike dhe përpunimin e tyre duke mbajtur informacion të detajuar për kartelën e një pajisje me të gjithë të dhënat e nevojshme;
- Hedhje të dhënave mbi vendndodhjen e pajisjeve teknike dhe përpunim i tyre;
- Përcaktimin dhe menaxhimin e lidhjes ndërmjet pajisjeve teknike;
- Mbledhjen e të dhënave mbi përdorimin e pajisjeve teknike, regjistrimin dhe menaxhimin e tyre;
- Përcaktimin i kodeve të defekteve teknike;
- Monitorimi i kushteve të pajisjeve teknike;
- Menaxhimi i rregullave specifike të sigurisë teknike;

## **2. Moduli i menaxhimit të punës**

Moduli i menaxhimit të punës ju mundëson përdoruesve të menaxhojnë si aktivitetet e planifikuara ashtu edhe ato të paplanifikuara të mirëmbajtjes, nga kërkesat fillestare të punës, në gjenerimin e urdhrit të punës, deri në kryerjen dhe regjistrimit urdhrave të punës të realizuara. Nëpërmjet këtij moduli mundësohet ndjekja dhe analizimi i detajuar i burimeve, materialeve, përdorimit të pajisjeve dhe kostove. Gjithashtu mundëson menaxhimin grafik të burimeve duke optimizuar oraret e mirëmbajtjes dhe përdorimin e forcës punonjëse.

Funksionaliteti parandalues i mirëmbajtjes (PM) i mundësojnë OSHEE që të skedulojë mirëmbajtjen parandaluese, oraret, aktivitetet e duhura të punës dhe kërkesat për burime.

Funksionet kryesore të modulit:

- Ndjekja e urdhrit të punës;
- Mirëmbajtje parandaluese;
- Mirëmbajtje ndërhyrëse;
- Menaxhimi i caktimit të punës;
- Menaxhimi i planeve të punës;
- Mbyllja e rendit të punës;
- Raportimin lidhur me punën e kryer;
- Raportime të ndryshme të detajuara sipas kërkesave.
- Kualifikimet dhe certifikatat e punonjësve;
- Menaxhimi i sigurisë në punë;
- Caktimi dhe menaxhimi i mjeteve të punës.



---

### **3. Moduli i menaxhimit të kontratave dhe shërbimeve**

Moduli i menaxhimit të shërbimeve i lejon përdoruesve fundor të krijojnë kërkesa të reja për shërbime, si dhe gjurmojnë dhe përditësojnë kërkesat e hapura të shërbimit.

Përcaktimi i shërbimeve të ofruara dhe nivelit të shërbimit të ofruar (SLAs) do të ndihmojnë OSHEE për të rritur komunikimin brenda organizatës dhe harmonizimin e niveleve të shërbimit me objektivat e biznesit.

OSHEE monitoron nivelin e ofruar të shërbimit në mënyrë pro-aktive për të shmangur mosarritjen e nivelit të shërbimit dhe të implementojë procedurat e përshkallëzimit për të menaxhuar siç duhet burimet njerëzore dhe për të arritur angazhimet në nivel shërbimesh.

Funksionalitet kryesorë të modulit të menaxhimit të shërbimeve përfshijnë sa më poshtë:

- Menaxhim të kërkesave për shërbim
- Menaxhim të marrëveshjeve mbi nivelin e shërbimit (SLA)
- Menaxhim i bazës së njohurive

Funksionalitet kryesorë të modulit të menaxhimit të kontratave përfshijnë sa më poshtë:

- Menaxhim të llojeve të ndryshme të kontratave (Kontratë pune, qiraje, kontratë blerje ose garancie etj.)
- Menaxhim i skedulimit të pagesave
- Menaxhim i kushteve dhe termave

### **4. Moduli i menaxhimit të materialeve dhe funksionalitetet e prokurimit**

Modulin e menaxhimit të materialeve mundëson regjistrimin e lëvizjeve dhe përshtatjeve të gjithë materialeve, të ofrojnë mundësi për ndjekjen në kohe reale të lëvizjes së materialeve, raportim dhe auditimi.

Funksionaliteti i këtij moduli optimizon dhe planifikon inventarin e OSHEE për të përmbushur kërkesat për mirëmbajtje dhe sigurimin se pjesët e duhura janë në dispozicion në vendndodhjen e duhur kur është e nevojshme.

Funksionet kryesorë të modulit të menaxhimit të materialeve përfshijnë:

- Inventar dhe përdorimi i tij.
- Përcaktimi, alokimi dhe menaxhimi i kodeve të gjendjes;
- Përcaktimi i artikujve, hyrja dhe menaxhimi i tyre;
- Menaxhim i mjetet dhe pajisjeve në stok.
- Përcaktimi i artikujve, hyrja dhe menaxhimi i magazinave.
- Përcaktimi i artikujve të shërbimit, hyrja dhe menaxhimi tyre.

Moduli i menaxhimit të prokurimit mbështesin OSHEE në të gjitha fazat e prokurimit, duke përfshirë blerjen e drejtpërdrejtë dhe rimbushjen e inventarit. Funksionalitetet e lidhura me modulin e prokurimit përfshijnë mjetet e analizës dhe treguesit e performancës (KPIs) për të

---

matur performancën e prokurimit siç është koha e përpunimit të urdhrit të blerjes, saktësia e faturës dhe kohëzgjatja e porosive

Funksionet kryesore të modulit të menaxhimit të prokurimit përfshijnë:

- Menaxhimi i kërkesave stacionare;
- Menaxhimi i kërkesave të blerjeve;
- Menaxhimi i porosive të blerjeve;
- Marrja dhe menaxhimi i dërgesave;
- Kërkesa për menaxhimin e kuotimit;
- Menaxhimi i faturave;

## **5. Moduli i përdorimit të sistemit në pajisje mobile**

Moduli i përdorimit të sistemit në pajisje mobile i ofron përdoruesve mobile akses të mbrojtur në të dhëna dhe shërbime në çdo kohë dhe kudo duke përdorur pajisje smart dhe tablet për të punuar online dhe offline. Ky modul duhet të jetë gjatë gjithë kohës funksional.

## **6. Funksionaliteti i skedulimit**

Sistemi ka funksionalitete për të menaxhuar, planifikuar dhe caktuar punën dhe burimet në organizatë në mënyrë grafike, duke krijuar oraret, duke përdorur pamjen grafike, hartat dhe kalendarët në atë mënyrë që përdoruesi mund të shohin kërkesat e punës dhe të burimeve që janë planifikuar.

## **7. Funksionalitete të raportimit dhe të analizës**

Sistemi ka funksionalitet për të gjeneruar dhe administruar raporte.

## **8. Faqet Kryesore**

Në sistem janë të konfiguruar faqet kryesore të mëposhtme:

## ***Menaxheri i Kontratave***

[illegible]

### *Dispeçeri*

[illegible]


*Krye-*

The screenshot shows the AWS IAM console with the 'Groups' tab selected. The table lists the following groups:

| Name                  | Type    | Users | Policies              | Groups |
|-----------------------|---------|-------|-----------------------|--------|
| AWS-ReadOnlyAccess    | Managed | 0     | 1 (AWSReadOnlyAccess) | 0      |
| AWS-ReadOnlyAccess-2  | Managed | 0     | 1 (AWSReadOnlyAccess) | 0      |
| AWS-ReadOnlyAccess-3  | Managed | 0     | 1 (AWSReadOnlyAccess) | 0      |
| AWS-ReadOnlyAccess-4  | Managed | 0     | 1 (AWSReadOnlyAccess) | 0      |
| AWS-ReadOnlyAccess-5  | Managed | 0     | 1 (AWSReadOnlyAccess) | 0      |
| AWS-ReadOnlyAccess-6  | Managed | 0     | 1 (AWSReadOnlyAccess) | 0      |
| AWS-ReadOnlyAccess-7  | Managed | 0     | 1 (AWSReadOnlyAccess) | 0      |
| AWS-ReadOnlyAccess-8  | Managed | 0     | 1 (AWSReadOnlyAccess) | 0      |
| AWS-ReadOnlyAccess-9  | Managed | 0     | 1 (AWSReadOnlyAccess) | 0      |
| AWS-ReadOnlyAccess-10 | Managed | 0     | 1 (AWSReadOnlyAccess) | 0      |

## Inxhinieri

## Punonjësi



## Punonjësi Rajonal i Logjistikes



## Administratori i OSHEE Maximo




## 5.2. Arkitektura e sistemit MX

Ambienti Test:




Ambienti testimit dhe pranimit nga përdoruesi




(UAT):

Ambienti Live (Production) ka strukturën e mëposhtme:



Ambienti i testimit dhe UAT ka strukturën e mëposhtme:




Ambienti i testimit dhe UAT për IBM Security Director Integrator – SDI ka një strukturë si më poshtë:



---

Ambienti Live (Production) për IBM Security Director Integrator – SDI ka një strukturë si më poshtë:



### 5.3. Infrastruktura “Hardware” mbështetëse


Infrastruktura mbështetëse “Hardware” ka ne perberje dy ambiente operimi, ambientin production dhe ambientin për testim dhe zhvillim.

Theksohet se keto ambiente jane të izoluar në mënyrë llogjike dhe fizike nga njëri-tjetri.

Ambienti production do te integrohet me infrastrukturen aktuale te OSHEE-se i cili është i zbatuar ne formën e një ambienti virtual duke perdorur teknologjine e virtualizimit te programit VMWare (versioni 8 ) I cili mundeson disponueshmëri të lartë, siguri, dhe pajtueshmeri te standarteve kombetare dhe nderkombetare.

Gjithashtu integrimi i ambientit production ben te mundur garantimin e rikthimit automatik të shërbimeve apo te te dhenave në rast incidenti qofte kibernetik, gabim njerezor apo deshtim te hardwar-it, pra duke ofruar teknologjinë me të fundit te backup dhe recovery, si dhe sherbimin business continuity.

Ambienti për test dhe zhvillim do te integrohet dhe optimizohet në formën e një ambienti virtual, të izoluar logjikisht dhe fizikisht prej ambientit production. Për ambientin test dhe zhvillim, ofrohet e njejta teknologji te ambjentit production, pra integrimi i tij ne infrastrukturen teknologjike te OSHEE-se.



Arkitektura logjike

Infrastruktura virtuale, mbi të cilën është mbështetur sistemi IBM MAXIMO ASSET MANAGEMENT është e teknologjisë VMWare versioni 8. Infrastruktura përbëhet nga 3 server-a fizikë HPE DL360 G10 te cilet do te integrohen ne vCenter-in qendror te OSHEE-s.. Këto tre server-a do te sherbejne shërbejnë si nyje virtualizimi.



Më poshtë jepen detaje mbi komponentët e infrastrukturës në të cilën është hostuar sistemi për menaxhimin e aseteve IBM Maximo:

- Server-a për virtualizim: modeli HPE DL360 Gen10 ( ESX-HOST 1 dhe 2) janë server-at të cilët janë pjesë e një 1 cluster-i VMWare VSphere 8.0 dhe ku është instaluar **ambienti virtual production** i sistemit të menaxhimit të aseteve IBM Maximo
- Serveri për test & development – modeli HPE DL360 Gen10 ESX-HOST 3, është serveri tek i cili është ngritur **ambienti virtual** Vsphere 8.0 **për testime dhe zhvillime të** sistemit të menaxhimit të aseteve IBM Maximo.

| Pershkrimi i Pajisjes    | Etiketimi | Nr Serial  |
|--------------------------|-----------|------------|
| HPE Proliant DL360 Gen10 | ESX-HOST1 | CZJ93705TJ |
| HPE Proliant DL360 Gen10 | ESX-HOST2 | CZJ93705TH |
| HPE Proliant DL360 Gen10 | ESX-HOST3 | CZJ93705TK |
| MSA 2050                 | OSHEE-MSA | 2S6932B288 |

Në shërbim të sistemit, janë implementuar tre ambiente virtuale: Production, Test, Development. Ambienti virtual *PRODUCTION* është ngritur mbi 2 server-at esx-host1 dhe esx-host2, të cilët janë pjesë e një clusteri VCenter. Ambientet virtuale TEST dhe DEV janë ngritur mbi serverin esx-host3.

**Në Ambientin virtual Production** janë provizionuar 6 makina virtuale, ndërsa në ambientet TEST dhe DEV janë provizionuar 10 makina virtuale. Gjithashtu në një nga hostet e production, esx-host1 është bërë deploy si një makine virtuale edhe serveri i VCenter nga ku kryhet menaxhimi dhe monitorimi i të gjithë infrastrukturës virtuale VMWare.

## 6. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR SHËRBIMIN E MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT

### 6.1. Specifikimet Teknike të Mirëmbajtjes së Sistemit

Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e sistemit MAXIMO janë si me poshtë:

1. Kontroll periodik i funksionimit normal të sistemit për komponentët e mëposhtme:
  - **Moduli i Menaxhimit të pajisjeve teknike;**
  - **Moduli i menaxhimit të punës;**
  - **Moduli i menaxhimit të kontratave dhe shërbimeve;**
  - **Moduli i menaxhimit të materialeve dhe funksionalitetet e prokurimit;**
  - **Moduli i përdorimit të sistemit në pajisje mobile;**
  - **Funksionaliteti i skedulimit;**
  - **Funksionalitete të raportimit dhe të analizës;**

- 
2. Diagnostikimi i problemeve që afektojnë sistemin për modulet e sipërpërmendura dhe marrjen e masave sipas rëndësisë. Përgatitja e një raporti shpjegues me sugjerimet përkatëse për problemin.
  3. Vlerësim i raporteve të monitorimit dhe përpilim i raporteve për përmirësimin e infrastrukturës, pa përjashtuar edhe sugjerimet në adresë të infrastrukturës. Diagnostikimin i detajuar për çdo problem apo keqfunksionim të pajisjeve HW dhe SW të sistemit. Analizë dhe përshkrim i masave që duhen marrë për parandalimin dhe zgjidhjen konkrete të dokumentuara të incidenteve.
  4. Zgjidhja e problemeve që afektojnë sistemin për modulet e sipërpërmendura në një afat kohe të caktuar sipas pikës 9 (Përgjigja dhe shkallëzimi i shërbimit).
  5. Suport aktiv nga Operatori për të mundur përdorimin korrekt të moduleve të sipërpërmendura të sistemit
  6. Zgjidhja e të gjitha problematikave të mundshme në modulet e sistemit.
  7. Zhvillime të nevojshme në modulet e sistemit bazuar në kërkesat e OSHEE Group Sh.a.
  8. Kontrollë periodike të mbarëvajtjes së proceseve të automatizuara të sistemit si jobs, scripts etj, të cilat kanë lidhje me azhurnime të vazhdueshme të të dhënave në sistem.
  9. Ndryshimi i faqeve kryesore (Start Centers) të grupeve të sigurisë sipas nevojave.
  10. Instalimi i upgrade-ve dhe patch-ve kur nevojiten për mbarëvajtjen e sistemit.
  11. Zgjidhjen e problemeve dhe gabimeve në fushën e administrimit të sistemeve.
  12. Azhurnim i informacionit bazuar në kërkesat e OSHEE Group Sh.a.
  13. Skema Test të jete e përditësuar, të kryhen verifikime për funksionalitetin normal të saj.
  14. Kompania duhet të përcaktojë një numër telefoni dhe e-mail si pikë kontakti në raste emergjence.
  15. Kompania duhet të garantojë suport në rast se një faktor i brendshëm apo i jashtëm afekton sistemin apo cënon cilësinë e punës. Përgatitja e një axhende të qartë të operacioneve ditore/ javore/ mujore/ vjetore të monitorimit të komponenteve përbërës të sistemeve sipas rëndësisë së tyre.
  16. Operatori ekonomik fitues duhet të dokumentojë çdo ndërhyrje në mjedisin Production, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjes. Autoriteti Kontraktues do të japë aprovimin paraprak për çdo ndërhyrje.
  17. Suporti i ofruar duhet të përfshijë kontrollet e detyrueshme parandaluese, si edhe të përshkruaj dinamikën dhe furnizojë të gjitha detajet teknike mbi aktivitet e planifikuara.
  18. Të përfshihen trajnime për administratorët e sistemit të OSHEE dhe për përdoruesit e sistemit në bazë të grupeve të sigurisë (roleve përkatëse).
  19. Përgatitja e manualeve të përdorimit për administratorët dhe përdoruesit dhe modifikimet përkatëse në rast ndryshimi të radhës së punës.

## **6.2. Specifikimet Teknike të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës “Hardware” mbështetëse**

Kërkohet nga Operatori Ekonomik të identifikojë problemet e raportuara dhe ndjekjen e tyre deri zgjidhje përfundimtare, duke bërë dhe eskalimet e nevojshme tek prodhuesit përkatës.

---

## **A. Shërbimi i mirëmbajtjes për Server-a**

Më qëllim që problemet teknike me server-at fizike të zgjidhen në mënyrë sa më të shpejtë dhe profesionale, në mënyrë që rikthimi në gjendje pune të behet sa më i shpejtë dhe eficient, kompania fituese do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen Hardware për të gjithë infrastrukturën e serverëve fizike të përshkruar më sipër.

Operatori ekonomik duhet të kryejë:

- Verifikim logjik nëpërmjet monitorimit periodik të logeve të serverëve fizike që janë pjesë aktive dhe mbështetëse e sistemit, për ndërhyrje që paraprijnë degradimin e pjesshëm ose total të komponentëve fizikë të serverëve;
- Verifikim fizik i pajisjeve, për sinjale që njoftojnë degradimin apo lindjen e problemeve të komponentëve të serverëve;
- Kontroll i statusit të serverëve nëpërmjet vetë faciliteteve/mjeteve të prodhuesit;
- Kontroll i statusit të disqeve nëpërmjet panelit të kontrollit;
- Kontroll i hapësirës së përdorur;
- Shërbime korrektuese për probleme të verifikuara gjatë kontrolleve rutinë të monitorimit, pasi është kryer procesi i diagnostikimit të hollësishëm, të raportuara nga stafi i përcaktuar për ndjekjen e kontratës së mirëmbajtjes
- Të kryejë procesin e delegimit të problemit, deri në zgjidhjen e plotë të tij, duke përfshirë edhe prodhuesin e pajisjeve;
- Verifikim për statusin e updateve dhe i firmware të ndryshëm;
- Rekomandime të mundshme hardware;

## **B. Shërbimi i mirëmbajtjes së Infrastrukturës virtuale**

Qëllimi i shërbimit në këtë komponent është mirëmbajtja e shërbimeve infrastrukturore të zgjidhjes hyperconverged. Qëllimi i shërbimit në këto komponentë është realizimi i proceseve të mëposhtme:

- Monitorimin periodik të përgjithshme të:
  - Nodeve ESXi
  - statusit të makinave virtuale dhe utilizimit të resurseve
  - Statusit të vCenter Server
- Përditësime versionit më të fundit të rekomanduar nga prodhuesi
- Ndërmarrja e veprimeve korrektuese për probleme të verifikuara gjatë kontrolleve rutinë të monitorimit, pasi është kryer procesi i diagnostikimit të hollësishëm, të raportuara nga stafi i përcaktuar për ndjekjen e kontratës së mirëmbajtjes
- Suport në rast nevojë, për konfigurim të burimeve virtuale sipas nevojës së sistemit dhe shërbimeve të ngritura.
- Kontrolli i procedurave të back-up, restore, dhe raportimi i tyre.
- Përditësime të licencave të nevojshme.

---

## C. Shërbimi i mirëmbajtjes për Sistemet Operative, Databazë, etj (Suport, licenca, etj).

1. Mirëmbajtjen dhe përditësimin (*update*) e këtyre sistemeve dhe bazës së të dhënave, në mënyrë që të garantohet stabiliteti dhe mos ndërprerja e shërbimit në asnjë rast.
2. Mirëmbajtjen dhe përditësimin (*update*) të serverave virtualë në mënyrë që të garantohet stabiliteti dhe mos ndërprerja e shërbimit në asnjë rast.
3. Analizimin e “event log-eve” për çdo server fizik/virtual dhe ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për të fiksuar problemet e mundshme.
4. Instalime dhe konfigurime të sistemit të operimit nëse do të jetë e nevojshme duke përfshirë softë ndihmëse për mirëfunksionimin e sistemit.
5. Diagnostikim dhe riparim të problemeve që mund të dalin gjatë periudhës së këtij shërbimi.

## 7. RAPORTIMI

### 7.1. Kërkesat për Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në origjinal dhe 1 kopje:

- **Raport Fillestar** që duhet të prodhohet pas 5 ditësh nga fillimi i punës. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruajë p.sh. gjetjet fillestare, progresin në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritur ose të hasur. Kontraktuesi duhet të vazhdojë punën derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar për ndryshime.
- **Raporti mujor** i cili duhet të dorëzohet çdo muaj nga operatori ekonomik në bazë të standartit të vendosur nga Autoriteti Kontraktor.
- **Drafti i raportit përfundimtar**. Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 5 dite para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, duhet të përfshijë komentet e pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e përfundimtar është 5 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet me të gjitha detajet.

### 7.2 Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raportet e përmendur më sipër duhet t'i dorëzohen Administratorit të Kontrates të identifikuar në kontratë. Administratorit të Kontrates është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

## 8. LOGJISTIKA DHE KOHA

### 8.1 Vendndodhja

Baza operative e projektit do të jetë në Tiranë. Sistemet janë ngritur në serverat ekzistues të OSHEE të cilët janë të instaluar në datacenter të OSHEE.

## 8.2 Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit të projekti do të jetë data e nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik apo bashkimin e operatorëve fitues të këtij projekti dhe periudha e integritetit do të mbulojë 36 muaj kalendarikë.

## 9. PËRGJIGJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT

Në tabelën e më poshtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre.

| Serioziteti 1 (Kritik)                                                                                                                           | Serioziteti 2 (I Mesëm)                                                                                                                                                                                                       | Serioziteti 3 (I Ulët)                                                                                                                                    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Rrezikimi i aktivitetit ekonomik dhe detyrime financiare</b>                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                           |
| Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime financiare të mëdha për përdoruesit ose rrezikon shumë aktivitetin ekonomik të përdoruesve.       | Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime financiare të konsiderueshme për përdoruesit ose rrezikon konsiderueshëm aktivitetin ekonomik të përdoruesve.                                                                  | Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime financiare minimale për përdoruesit ose rrezikon në mënyrë minimal aktivitetin ekonomik të përdoruesve.    |
| <b>Pezullimi i punës</b>                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                           |
| Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.                                             | Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre, por ata janë në gjendje të realizojnë pjesën tjetër. Mund të përfshijë gjithashtu pyetje dhe përgjigje për informacion. | Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të realizojnë një pjesë të vogël të punës së tyre, por ata janë në gjendje të realizojnë pjesën tjetër. |
| <b>Numri i përdoruesve të ndikuar</b>                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                           |
| Mos funksionimi i aplikacionit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve.                                                                    | Mos funksionimi i aplikacionit ndikon një numër shumë të vogël të përdoruesve.                                                                                                                                                | Mos funksionimi i aplikacionit ndikon në 1 (një) ose 2 (dy) përdorues.                                                                                    |
| <b>Zgjidhje alternative e përkohshme [Kjo ka peshën më të madhe të karakteristikave të Seriozitetit 1 dhe 2]</b>                                 |                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                           |
| Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit (p.sh. puna nuk mund të realizohet në një mënyrë tjetër) | Mund të ketë ose jo një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.                                                                                                                         | Potencialisht ekziston një mënyrë alternative e përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.                                                   |
| <b>Koha e përgjigjes</b>                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                           |

|                                                                                      |                                                                                   |                                                              |
|--------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|
| Brenda një ore.                                                                      | Brenda 8(tetë)orëve ose ditën tjetër të punës.                                    | Brenda 8(tetë)orëve ose ditën tjetër të punës.               |
| <b>Koha e zgjidhjes</b>                                                              |                                                                                   |                                                              |
| Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 orë të vazhdueshme pas kontaktit të parë. | Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 20 ditëve të vazhdueshme të punës. | Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 45 dite kalendarike. |

### Penalitetet për mos-arritje të nivelit të shërbimit

Nëse kompania fituese nuk arrin të kryejë shërbimin sipas kohëve të përcaktuara më sipër do të mbahet 10% e pagesës nga fatura mujore e mirëmbajtjes.

### FORMULARI I OFERTES EKONOMIKE

| 1  | 2                                                           | 3       | 4           | 5           | 6                                           |
|----|-------------------------------------------------------------|---------|-------------|-------------|---------------------------------------------|
| Nr | Përshkrimi i Shërbimeve                                     | Sasia   | Çmimi Njësi | Çmimi Total | Afati                                       |
| 1  | “Mirëmbajtjen e sistemit MAXIMO per nje periudhe 3 vjeçare” | 36 muaj |             |             | 36 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës |
|    | <b>Çmimi Neto</b>                                           |         |             |             |                                             |
|    | <b>TVSH (20%)</b>                                           |         |             |             |                                             |
|    | <b>Çmimi Total</b>                                          |         |             |             |                                             |

### ANEKS 3: PLANI I MIREMBAJTJES

Mëposhtë paraqitet Diagrama Gant për realizimin e përmirësimeve të kërkuara.

| Funksionaliteti | M1 | M2 | M3 | M4 | M5 | M6 | ..... | M36 |
|-----------------|----|----|----|----|----|----|-------|-----|
| Mirëmbajtja     |    |    |    |    |    |    |       |     |

---

## Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

---

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 **Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**



---

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare:

- 1) **ISO 9001** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- 2) **ISO 27001** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);
- 3) **ISO/IEC 20000-1** ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit (e vlefshme);

---

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave / shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

**2.3.3.** Operatori Ekonomik duhet të jete i Autorizuar nga Prodhuesi/Distributori i autorizuar për shitjen e suportit për sistemin software Maximo Asset Management.

***Ky kriter të provohet nepermjet dokumentacionit të leshuar nga prodhuesi/distributori i autorizuar në emër të Operatorit Ekonomik për territorin e Shqipërisë***

**2.3.4.** Operatori Ekonomik duhet të jete i autorizuar nga Prodhuesi/Distributori i autorizuar i pajisjeve server dhe storage në objekt të kësaj procedure.

***Ky kriter të provohet nepermjet dokumentacionit të leshuar nga prodhuesi/distributori i autorizuar në emër të Operatorit Ekonomik për territorin e Shqipërisë.***

**2.3.5.** Operatori Ekonomik duhet të jete i autorizuar nga prodhuesi për të ofruar shërbimet e mirembajtjes për pajisjet hardware në objekt të kësaj procedure.

***Ky kriter të provohet nepermjet dokumentacionit të leshuar nga prodhuesi/distributori i autorizuar në emër të Operatorit Ekonomik për territorin e Shqipërisë.***

**2.3.6** Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas termave të references, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 10 (Dhjetë) punonjës të cilët të figurojnë në listpagesa të pakten në muajin e fundit nga data e hapjes së procedurës. Punonjesit si mëson për të jete:

- Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar në menaxhimin e ofrimit të shërbimeve ITIL ose ekuivalente.
- Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për analizë sistemesh
- Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar si testues software
- Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për databazë relacionale
- Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për ciklin e zhvillimit software
- Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e sistemeve operativ
- Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për platformën e virtualizimit ku mbështetet platforma për menaxhimin operacional -teknik të aseteve të rrjetit
- Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për pajisjet server dhe storage ku është implementuar platforma për menaxhimin operacional -teknik të aseteve të rrjetit
- Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar/trajnuar nga prodhuesi ose institucione të akredituara nga prodhuesi për platformën e menaxhimit operacional -teknik të aseteve të rrjetit

***Një punonjës mund të disponojë më shumë se një certifikim.***

---

**Për të vërtetuar disponimin e stafit të mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

- Certifikata përkatëse të kualifikimit.
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, *(duke marrë si reference data e hapjes së ofertave)*.
- Kontratën/at e punës konform legjislacionit në fuqi të lidhura me stafin e nevojshëm dhe CV-në.

**Sqarim :** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**Shenim :** Sqarojme të gjithë operatorët ekonomik që në rast mosperputhje ndërmjet versionit anglisht të DT dhe atij në shqip, do të prevalojë versioni shqip i DT.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

| Identifikimi                                                                                                                                              | Përgjigjja |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | -----      |
| Numri NIPT/et:                                                                                                                                            | -----      |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar                                                                                                           | -----      |
| Përfaqësuesi (emri):                                                                                                                                      | -----      |
| Telefoni:                                                                                                                                                 | -----      |
| E-mail:                                                                                                                                                   | -----      |

#### B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT –i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
|-------------------------------------|---------|-----------------------------|-----------------------------------------------------------|
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|------------------------|--------|----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|
|                        |        |                                                                      |                                      |
|                        |        |                                                                      |                                      |
|                        |        |                                                                      |                                      |
|                        |        |                                                                      |                                      |

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

| Deklarata                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                |
| <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p> |

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime \_\_\_\_\_ nëse \_\_\_\_\_ vlerësohet \_\_\_\_\_ e  
nevojshme \_\_\_\_\_

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër<sup>7</sup>.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me:

çmimet;  
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;  
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,  
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

## C: DEKLARATA

<sup>7</sup> Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

## Mbi Konfliktin e Interesit

### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrit, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.



## D: DEKLARATA

### Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Deklarata</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
